



REPUBLIKA E KOSOVËS - РЕПУБЛИКА КОСОВО - REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA KUSHTETUESE
УСТАВНИ СУД
CONSTITUTIONAL COURT

Prishtinë, më 15 korrik 2019
Nr.ref.:RK 1396/19

AKTVENDIM PËR PAPRANUESHMËRI

në

rastin nr. KI35/19

Parashtrues

Ramiz Hajdini

Vlerësim i kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të Gjykatës Supreme të Republikës së Kosovës, Rev. nr. 207/2018, të 7 gushtit 2018

GJYKATA KUSHTETUESE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS

e përbërë nga:

Arta Rama-Hajrizi, kryetare
Bajram Ljatifi, zëvendëskryetar
Bekim Sejdiu, gjyqtar
Selvete Gërxhaliu-Krasniqi, gjyqtare
Gresa Caka-Nimani, gjyqtare
Safet Hoxha, gjyqtar
Radomir Laban, gjyqtar
Remzije Istrefi-Peci, gjyqtare dhe
Nexhmi Rexhepi, gjyqtar

Parashtruesi i kërkesës

1. Kërkesa është dorëzuar nga Ramiz Hajdini, me banim në Drobesh, Komuna e Vitisë, i cili përfaqësohet nga avokati Halim Shala (në tekstin e mëtejme: parashtruesi i kërkesës).

Vendimi i kontestuar

2. Parashtruesi i kërkesës konteston Aktgjykimin [Rev. nr. 207/2018] e 7 gushtit 2018 të Gjykatës Supreme të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejshëm: Gjykata Supreme) në lidhje me Aktgjykimin [Ac. nr. 807/2013] e 7 marsit 2018 të Gjykatës së Apelit dhe Aktgjykimin [C. nr. 252/2009] e 31 janarit 2013 të Degës në Viti të Gjykatës Themelore në Gjilan (në tekstin e mëtejshëm: Gjykata Themelore).
3. Parashtruesi i kërkesës e ka pranuar Aktgjykimin e kontestuar më 18 shtator 2018.

Objekti i çështjes

4. Objekt i çështjes së kërkesës është vlerësimi i kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të kontestuar, përmes të cilit parashtruesi i kërkesës pretendon se i janë shkelur të drejtat dhe liritë e tij themelore të garantuara me nenet 24 [Barazia para Ligjit], 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm], 32 [E Drejta për Mjete Juridike] dhe 54 [Mbrotjtja Gjyqësore e të Drejtave] të Kushtetutës së Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejshëm: Kushtetuta).

Baza juridike

5. Kërkesa bazohet në paragrafët 1 dhe 7 të nenit 113 [Juridiksioni dhe Palët e Autorizuara] të Kushtetutës, nenet 22 [Procedimi i kërkesës] dhe 47 [Kërkesa individuale] të Ligjit për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës, nr. 03/L-121 (në tekstin e mëtejshëm: Ligji) dhe rregullin 32 [Parashtrimi i kërkesave dhe përgjigjeve] të Rregullores së punës së Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejshëm: Rregullorja e punës).

Procedura në Gjykatën Kushtetuese

6. Më 28 shkurt 2019, parashtruesi e dorëzoi kërkesën në Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejshëm: Gjykata).
7. Më 4 mars 2019, Kryetarja e Gjykatës caktoi gjyqtaren Gresa Caka-Nimani Gjyqtare raportuese dhe Kolegjin shqyrtues, të përbërë nga gjyqtarët: Bajram Ljatifi (kryesues), Safet Hoxha dhe Radomir Laban.
8. Më 14 mars 2019, Gjykata njoftoi përfaqësuesin e parashtruesit për regjistrimin e kërkesës, si dhe kërkoi të paraqitet fletëkthesa që dëshmon se kur është pranuar Aktgjykimi i kontestuar i Gjykatës Supreme.
9. Më 14 mars 2019, Gjykata gjithashtu njoftoi Gjykatën Supreme për regjistrimin e kërkesës. Në po të njëjtën datë, Gjykata dërgoi një kërkesë në Gjykatën Themelore, për të paraqitur dëshmi lidhur me datën e pranimi të vendimit të kontestuar të Gjykatës Supreme nga parashtruesi i kërkesës.

10. Më 14 mars 2019, Gjykata njoftoi palët e interesuara B.S. dhe Sh.S., për regjistrimin e kërkesës.
11. Më 27 mars 2019, përfaqësuesi i parashtruesit të kërkesës, paraqiti para Gjykatës dëshminë e pranimit të Aktgjykimit të kontestuar.
12. Më 27 mars 2019, Gjykata Themelore i dorëzoi Gjykatës fletëkthesën e cila tregon se parashtruesi i kërkesës kishte pranuar Aktgjykimin e kontestuar më 18 shtator 2018.
13. Më 4 maj 2019, në pamundësi të gjetjes së palëve të interesuara B. S. dhe Sh. S., Posta e Kosovës ka kthyer zarfin në Gjykatë.
14. Më 20 qershor 2019, Kolegji shqyrtues e shqyrtoi raportin e Gjyqtares raportuese dhe njëzëri i rekomandoi Gjykatës papranueshmërinë e kërkesës.

Përmbledhja e fakteve

15. Më 4 shtator 2006, parashtruesi i kërkesës ushtroi padi për kthimin e huas, kundër të paditurve B. S. dhe Sh. S., me vlerë të kontestit prej 35.000 (tridhjetë e pesë mijë) frangave zvicerane.
16. Përgjatë procedurës gjyqësore në Gjykatën Komunale të Vitisë, parashtruesi i kërkesës gjithashtu kishte bërë kërkesë për përjashtimin e gjyqtarit N. M. Më 21 mars 2008, përmes Aktvendimit [C.nr.183/2006], Kryetari i Gjykatës përkatëse Komunale kishte refuzuar kërkesën për përjashtimin e gjyqtarit si të pabazuar.
17. Më 26 janar 2009, Gjykata Komunale në Viti, përmes Aktgjykimit [C. nr. 183/06], e refuzoi kërkesëpadinë e parashtruesit të kërkesës si të pabazuar.
18. Më 16 shkurt 2009, parashtruesi i kërkesës paraqiti ankesë kundër Aktgjykimit të lartcekur në Gjykatën e Qarkut në Gjilan, duke pretenduar shkelje esenciale të dispozitave të procedurës kontestimore, konstatim të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike dhe aplikim të gabuar të së drejtës materiale.
19. Më 8 qershor 2009, Gjykata e Qarkut në Gjilan, përmes Aktvendimit [AC. nr. 115/09], e aprovoi ankesën e parashtruesit të kërkesës duke e kthyer çështjen në rivendosje.
20. Më 31 janar 2013, Gjykata Themelore përmes Aktgjykimit [C. nr. 252/2009] e refuzoi kërkesëpadinë e parashtruesit të kërkesës.
21. Më 4 mars 2013, parashtruesi i kërkesës paraqiti ankesë kundër Aktgjykimit të lartcekur të Gjykatës Themelore duke pretenduar shkelje esenciale të dispozitave të procedurës kontestimore, konstatim të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike dhe aplikim të gabuar të së drejtës materiale.

22. Më 7 mars 2018, Gjykata e Apelit përmes Aktgjykimit [Ac. nr. 807/2013] e refuzoi ankesën e parashtruesit të kërkesës si të pabazuar dhe vërtetoi Aktgjykimin e Gjykatës Themelore.
23. Më 23 prill 2018, parashtruesi i kërkesës paraqiti revizion në Gjykatën Supreme për shkak të shkeljes esenciale të dispozitave të procedurës kontestimore dhe aplikimit të gabuar të së drejtës materiale.
24. Më 7 gusht 2018, Gjykata Supreme përmes Aktgjykimit [Rev.nr.207/2018] refuzoi si të pabazuar revizionin.

Pretendimet e parashtruesit të kërkesës

25. Parashtruesi i kërkesës pretendon që Aktgjykimi [Rev. nr. 207/2018] i 7 gushtit 2018 i Gjykatës Supreme, i cili kishte shpallur të pabazuar kërkesën e tij për revizion, është nxjerrë në shkelje të të drejtave dhe lirive të tij themelore të garantuara me nenet 24 [Barazia para Ligjit], 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm], 32 [E Drejta për Mjete Juridike] dhe 54 [Mbrotjtja Gjyqësore e të Drejtave] të Kushtetutës.
26. Sa i përket shkeljeve të pretenduara të nenit 24 të Kushtetutës, parashtruesi i kërkesës pretendon shkelje të parimit të barazisë së armëve, duke theksuar se gjykatat kanë refuzuar kërkesëpadinë e tij, përkundër faktit që i padituri kishte bërë pranimin e borxhit përkatës.
27. Sa i përket shkeljeve të pretenduara të nenit 31 të Kushtetutës, parashtruesi i kërkesës pretendon se gjykata nuk ka qenë e paanshme, sepse Aktgjykimi në Gjykatën Komunale është nxjerrë nga një gjyqtar përjashtimin e të cilit e kishte kërkuar parashtruesi i kërkesës.
28. Sa i përket shkeljeve të pretenduara të neneve 32 e 54 të Kushtetutës, parashtruesi i kërkesës pretendon shkelje të së drejtës së tij në mjet juridik sepse *“kërkesat dhe parashtruesat”* e tij ishin refuzuar gjatë procedurave para gjykatave të rregullta.
29. Parashtruesi i kërkesës gjithashtu pretendon shkelje esenciale të dispozitave procedurale të përcaktuara me paragrafët 2.1 dhe 3.2 të nenit 2 dhe pikave (d) e (g) të nenit 67 të Ligjit nr. 03/L-006 të Procedurës Kontestimore.
30. Në fund, parashtruesi i kërkesës kërkon nga Gjykata që kërkesa e tij të shpallet e pranueshme dhe të shpallet i pavlefshëm Aktgjykimi [Rev. nr. 207/2018] i 7 gushtit 2018 i Gjykatës Supreme.

Vlerësimi i pranueshmërisë së kërkesës

31. Gjykata së pari shqyrton nëse kërkesa i ka përmbushur kriteret e pranueshmërisë, të përcaktuara me Kushtetutë dhe të specifikuara më tej me Ligj dhe të përcaktuara me Rregullore të punës.

32. Në këtë drejtim, Gjykata i referohet paragrafëve 1 dhe 7 të nenit 113 [Juridiksioni dhe Palët e Autorizuara] të Kushtetutës, të cilët përcaktojnë:

“1. Gjykata Kushtetuese vendos vetëm për rastet e ngritura para gjykatës në mënyrë ligjore nga pala e autorizuar.

[...]

7. Individët janë të autorizuar të ngrenë shkeljet nga autoritetet publike të të drejtave dhe lirive të tyre individuale, të garantuara me Kushtetutë, mirëpo vetëm pasi të kenë shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj”.

33. Gjykata gjithashtu vlerëson nëse parashtruesi i kërkesës ka përmbushur kriteret e pranueshmërisë, siç specifikohet më tej në Ligj. Në lidhje me këtë, Gjykata së pari i referohet nenit 47 [Kërkesa individuale] dhe 48 [Saktësimi i kërkesës] të Ligjit, të cilët përcaktojnë:

Neni 47
[Kërkesa individuale]

“1. Çdo individ ka të drejtë të kërkojë nga Gjykata Kushtetuese mbrojtje juridike në rast se pretendon se të drejtat dhe liritë e tij individuale të garantuara me Kushtetutë janë shkelur nga ndonjë autoritet publik.

2. Individ i mund të ngre kërkesën në fjalë vetëm pasi që të ketë shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj”.

Neni 48
[Saktësimi i kërkesës]

“Parashtruesi i kërkesës ka për detyrë që në kërkesën e tij të qartësoj saktësisht se cilat të drejta dhe liri pretendon se i janë cenuar dhe cili është akti konkret i autoritetit publik të cilin parashtruesi dëshiron ta kontestoj”.

34. Për sa i përket përmbushjes së këtyre kriterëve, Gjykata konstaton se parashtruesi i kërkesës është palë e autorizuar, i cili konteston një akt të një autoriteti publik, përkatësisht Aktgjykimin [Rev. nr. 207/2018] e 7 gushtit 2018 të Gjykatës Supreme, pasi i ka shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj. Parashtruesi i kërkesës gjithashtu ka sqaruar të drejtat dhe liritë që ai pretendon se i janë shkelur, në pajtim me kërkesat e nenit 48 të Ligjit.
35. Megjithatë, Gjykata shqyrton nëse janë përmbushur kriteret e përcaktuara me nenin 49 [Afatet] të Ligjit dhe pikën (c) të paragrafit (1) të rregullit 39 [Kriteret e pranueshmërisë] të Rregullores së punës. Ato përcaktojnë si në vijim:

Neni 49
[Afatet]

“Kërkesa parashtrohet brenda afatit prej katër (4) muajve. Afati fillon të

ecë që nga dita kur parashtruesit i është dorëzuar vendimi gjyqësor ...".

Rregulli 39
[Kriteret e Pranueshmërisë]

"(1) Gjykata mund ta konsiderojë një kërkesë të pranueshme nëse:

[...]

c) kërkesa parashtrohet brenda 4 (katër) muajsh nga dita e dorëzimit të vendimit të mjetit të fundit juridik efektiv të parashtruesi; ose

[...]".

36. Në këtë aspekt, Gjykata rikujton që parashtruesi i kërkesës konteston Aktgjykimin [Rev. nr. 207/2018] e 7 gushtit 2018 të Gjykatës Supreme. Dëshmia e paraqitur nga përfaqësuesi i parashtruesit të kërkesës dhe fletëkthesa e dorëzuar në Gjykatë nga Gjykata Themelore, vërtetojnë që parashtruesi i kërkesës ka pranuar Aktgjykimin e kontestuar më 18 shtator 2018.
37. Gjykata vëren që parashtruesi i kërkesës ka dorëzuar kërkesën e tij në Gjykatë më 28 shkurt 2019. Rrjedhimisht, Gjykata konstaton se kërkesa e parashtruesit të kërkesës është dorëzuar pas afatit ligjor prej 4 (katër) muajsh të përcaktuar më Ligj dhe Rregullore të punës.
38. Gjykata rikujton se qëllimi i afatit ligjor prej 4 (katër) muajsh, sipas nenit 49 të Ligjit dhe sipas rregullit 39 (1) (c) të Rregullores së punës, është që të promovojë siguri juridike, duke siguruar që rastet që kanë të bëjnë me çështje kushtetuese të trajtohen brenda një periudhe të arsyeshme dhe që vendimet e mëparshme të mos jenë vazhdimisht të hapura për t'u kontestuar. (Shih, ndër të tjera, rastet e GJEDNJ-së: *O'Loughlin dhe të tjerët kundër Mbretërisë së Bashkuar*, kërkesa nr. 23274/04, Aktvendim i 25 gushtit 2005; *Sabri Güneş kundër Turqisë*, kërkesa nr. 27396/06, Aktgjykim i 29 Qershorit 2012, paragrafi 39; shih gjithashtu, ndër të tjera, rastet e Gjykatës KI140/13, me parashtrues *Ramadan Cakiqi*, Aktvendimi për papranueshmëri, i 17 marsit 2014, paragrafi 24 e KI120/17, me parashtrues *Hafiz Rizahu*, Aktvendimi për papranueshmëri, i 7 dhjetorit 2017, paragrafi 39).
39. Si përfundim, nga arsyet e shtjelluara si më sipër, Gjykata konstaton se kërkesa nuk është dorëzuar brenda afatit ligjor të përcaktuar me nenin 49 të Ligjit dhe rregullit 39 (1) (c) të Rregullores së punës dhe rrjedhimisht, Gjykata nuk mund të shqyrtojë meritat e rastit, përkatësisht, pretendimet për shkelje kushtetuese të parashtruesit të kërkesës.
40. Rrjedhimisht, Gjykata konstaton se kërkesa është e papranueshme, sepse është parashtruar jashtë afatit të paraparë ligjor.

PËR KËTO ARSYE

Gjykata Kushtetuese, në pajtim me nenin 113.1 dhe 113.7 të Kushtetutës, me nenin 49 të Ligjit dhe rregullin 39 (1) (c) të Rregullores së punës, me 20 qershor 2019, njëzëri

VENDOS

- I. TË DEKLAROJË kërkesën të papranueshme;
- II. T'UA KUMTOJË këtë vendim palëve;
- III. TË PUBLIKOJË këtë Aktvendim në Gazetën Zyrtare, në pajtim me nenin 20.4 të Ligjit; dhe
- IV. Ky Aktvendim hyn në fuqi menjëherë.

Gjyqtarja raportuese

Gresa Caka Nimani
Gresa Caka-Nimani



Kryetarja e Gjykatës Kushtetuese

Arta Rama-Hajrizi
Arta Rama-Hajrizi



REPUBLIKA E KOSOVËS - РЕПУБЛИКА КОСОВО - REPUBLIC OF KOSOVO

**GJYKATA KUSHTETUESE
УСТАВНИ СУД
CONSTITUTIONAL COURT**

Prishtinë, më 12 shtator 2019
Nr. ref.:UK 1429/19

Në pajtim me nenin 112 [Parimet e Përgjithshme] të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, me nenin 11.1.4 të Ligjit për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës dhe me rregullin 65 [Përmirësimi i vendimeve] të Rregullores së punës së Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës, Gjykata Kushtetuese e Republikës së Kosovës nxjerr Urdhrin për korrigjim në vijim, me qëllim të korrigjimit të një gabimi teknik në Aktvendimin për papranueshmëri të publikuar në rastin KI35/19, të 20 qershorit 2019.

URDHËR PËR KORRIGJIM

të gabimit teknik në Aktvendimin për papranueshmëri në rastin KI35/19, të 20 qershorit 2019

1. Më 20 qershor 2019, Gjykata, njëzëri, e deklaroi kërkesën në rastin KI35/19 të papranueshme sepse e njejta ishte parashtruar jashtë afatit të paraparë ligjor prej katër (4) muajsh të përcaktuar në nenin 49 të Ligjit dhe rregullin 39 (1) (c) të Rregullores së punës (shih paragrafët 14, 39-40, si dhe pjesën operative të Aktvendimit për papranueshmëri në rastin KI35/19).
2. Më 17 korrik 2019, Gjykata e njoftoi parashtruesin e kërkesës për vendimmarrjen e Gjykatës dhe i dërgoi atij një kopje të Aktvendimit për papranueshmëri për rastin KI35/19.
3. Më 5 gusht 2019, parashtruesi i kërkesës parashtroi një shkresë në Gjykatë të cilën e kishte emërtuar si *“Parashtresë/Sqarim lidhur me Aktvendimin për papranueshmëri”*, duke vënë theks në dy gabime teknike të pretenduara nga ana e tij.
4. Së pari, përmes kësaj shkrese parashtruesi i kërkesës theksoi se ai e ka dorëzuar kërkesën e tij KI35/19 në Gjykatë më 21 shkurt 2019 e jo me 28 shkurt 2019, siç është theksuar në Aktvendim për papranueshmëri të Gjykatës. Kjo sepse, sipas tij, ai e ka dorëzuar kërkesën e tij me postë dhe jo personalisht dhe për rrjedhojë duhet të llogaritet data kur ai e ka dorëzuar kërkesën e tij më postë, respektivisht 21 shkurtin 2019.
5. Së dyti, parashtruesi i kërkesës theksoi si në vijim: *“Në pikën 37 [Sqarim: parashtruesi i referohet paragrafit 37 numerikisht por në fakt është paragrafi 36 të cilit ai i referohet në substancë] të Aktvendimit data e mbërritjes (17.08.2018)*

në Viti është data siç ju keni vlerësuar në Aktvendim por nuk është data e dorëzimit tek pala por vetëm e mbërritjes në shërbimin postar të Gj.TH. Vitisë.”

6. Në këtë aspekt, Gjykata thekson se të dy kërkesat e parashtruesit për korrigjim të ndonjë gabimi teknik ose numerik, Gjykata do t'i vlerësojë bazuar në rregullin 65 [Përmirësimi i vendimeve] të Rregullores së punës, i cili parasheh:

“(1) Gjykata mund, të korrigjojë ndonjë gabim teknik ose numerik në aktgjykim ose në vendim.

(2) Korrigjimi i vendimeve mund të bëhet ex officio, ose me kërkesën e palës, të paraqitur brenda dy javësh nga dorëzimi i vendimit.

(3) Urdhri për korrigjim i bashkëngjitet vendimit fillestar.”

7. Fillimisht, Gjykata konstaton se parashtruesi i kërkesës si palë e interesuar në rastin KI35/19 e ka paraqitur kërkesën e tij për korrigjim të Aktvendimit për papranueshmëri brenda afatit dy javor të përcaktuar në rregullin e lartcekur dhe Gjykata po vepron dhe vihet në lëvizje bazuar në kërkesën e tij dhe jo *ex officio*.
8. Për sa i përket kërkesës së parë të parashtruesit, Gjykata konstaton se ka pasur një gabim numerik i cili duhet të korrigjohet dhe në vend të datës 28 shkurt 2019 duhet të vendoset data 21 shkurt 2019, në dy paragrafë përkatës siç theksohet specifikisht në urdhërin e mëposhtëm.
9. Për sa i përket kërkesës së dytë të parashtruesit, Gjykata konstaton se pohimet e parashtruesit nuk janë korrigjime të natyrës teknike apo numerike dhe si të tilla nuk hyjnë në fushën e korrigjimeve që mund të bëhen nga Gjykata. Për më tepër që pretendimet e parashtruesit të kërkesës për gabim përkitazi me datën e pranimit të Aktgjykimit të kontestuar nuk qëndrojnë. Gjykata rikujton që datën e kontestuar të 18 shtatorit 2018, si datë kur parashtruesi i kërkesës e ka pranuar vendimin e kontestuar të Gjykatës Supreme [Rev.nr.207/2018] të 7 gushtit 2018, Gjykata e ka marrë nga kopja e fletëkthesës që Gjykata Themelore e ka dorëzuar në Gjykatën Kushtetuese pas kërkesës së kësaj të fundit. Në këtë aspekt, Gjykata rikujton se Gjykata Themelore e kishte dërguar fletëkthesën në fjalë si dëshmi për të provuar datën kur parashtruesi i kërkesës apo i autorizuari i tij e kanë pranuar vendimin e kontestuar të Gjykatës Supreme dhe kjo kishte ndodhur pasi që Gjykata Kushtetuese e kishte pyetur specifikisht për një gjë të tillë Gjykatën Themelore me anë të një shkrese zyrtare (shih, paragrafët 8 dhe 12 të Aktvendimit për papranueshmëri në rastin KI35/19 ku flitet për procedurat para Gjykatës).
10. Gjykata në fund rithekson se vendimi i saj për shpallje të kërkesës si të paafatshme qëndron dhe është i saktë edhe pas pranimit të korrigjimit të gabimit numerik për sa i takon datës së pranimit të kërkesës KI35/19 në Gjykatë. Edhe me korrigjimin numerik të kësaj date rrjedh që kërkesa e parashtruesit është dorëzuar gati dy muaj pas kalimit të afatit 4 muaj të paraparë me nenin 49 të Ligjit dhe rregullin 39 (1) (c) të Rregullores së punës.
11. Si përfundim, nga sa u tha më lart, Gjykata gjen se ka pasur dy gabime numerike në Aktvendimin për papranueshmëri të Gjykatës në rastin KI35/19 të 20

qershorit 2019 dhe të dyjat ndërlihen me datën e dorëzimit të kërkesës KI35/19 në Gjykatë.

12. Rrjedhimisht, Gjykata lëshon këtë:

URDHËR

- I. Paragrafi 6 i Aktvendimit për papranueshmëri në rastin KI35/19 ndryshohet ashtu që fraza “Më 28 shkurt 2019, parashtruesi e dorëzoi kërkesën” zëvendësohet me frazën “Më 21 shkurt 2019, parashtruesi, përmes shërbimeve postare, e dorëzoi kërkesën”. Pjesa tjetër e fjalisë mbetet e njëjtë;
- II. Paragrafi 37 i Aktvendimit për papranueshmëri në rastin KI35/19 ndryshohet ashtu që fraza “më 28 shkurt 2019” në fjalinë e parë të këtij paragrafi zëvendësohet me frazën “më 21 shkurt 2019”. Pjesa tjetër e fjalisë mbetet e njëjtë;
- III. Ky urdhër do t'i bashkëngjitet Aktvendimit fillestar për papranueshmëri të Gjykatës, në pajtim me rregullin 65 (3) të Rregullores së punës;
- IV. Ky urdhër do t'u komunikohet palëve dhe do të publikohet në Gazetën Zyrtare, në pajtim me nenin 20 (4) të Ligjit për Gjykatën Kushtetuese;
- V. Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë.

Kryetarja e Gjykatës Kushtetuese

Arta Rama-Hajrizi

